



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 03. nëntor 2011
Nr. ref.: RK 152 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 105/10

Parashtrues

Muris Alomerović

Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 198/2009, të 17 korrikut 2009 dhe Mia nr. 7/2009, të 27 gushtit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Muris Alomerović, me vendbanim në Mitrovicë, i përfaqësuar nga znj. Shefkije Bunjaku, avokate nga Prishtina, e cila vepron në bazë të autorizimit të certifikuar të datës 28 tetor 2010.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston aktgjykimet e Gjykatës Supreme nr. 198/2009, të 17 korrikut 2009 dhe Mia nr. 7/2009, të 27 gushtit 2010. Aktgjykimi i fundit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 shtator 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon të bëhet vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se Gjykata Supreme kishte gjetur gabimisht se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës nuk duhej konsideruar si palë e autorizuar, kompetente për të paraqitur kërkesë për parcelizimin dhe bartjen e paluajtshmërisë pranë organit përkatës të Komunës së Mitrovicës.
4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me atë rast Gjykata Supreme ia ka cenuar të drejtat nga neni 24 [Barazia para ligjit] dhe neni 46 [Mbrojtja e pronës] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 15 janar 2009 (Nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejme: Gjykata) dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 15 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 16 dhjetor 2010, Kryetari, me Urdhër Nr. GJR 105/10, e emëroi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me Urdhër Nr. KSH. 105/10, Kryetari e emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Enver Hasani.
9. Më 19 janar 2011, kërkesa iu përcoll Gjykatës Supreme.
10. Më 4 tetor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 27 nëntor 2008, Departamenti i Kadastrës dhe Gjeodezisë i Komunës së Mitrovicës e refuzoi kërkesën e Ndërmarrjes Shoqërore "Gornji Ibar" nga Rozhaja, Mali i Zi (në tekstin e mëtejme: NSH Gornji Ibar) në lidhje me parcelizimin dhe bartjen e të drejtës mbi disa ngastra të caktuara kadastrale në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe refuzoi t'i regjistronte këto ngastra për shkak të mungesës së provave relevante që do të arsyetonin bazën juridike të kërkesës.
12. Departamenti dha arsyetimin se NSH-ës i ishte dhënë mundësia të kompletonte dokumentacionin brenda një afati të caktuar, por se një gjë e tillë nuk kishte ndodhur. Duke marrë parasysh periudhën e gjatë kohore që kishte kaluar si dhe dyshimet që

ekzistonin në lidhje me vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga përfaqësuesi i NSH-së, shërbimet e Komunës ishin munduar të gjenin dokumentacionin original që ishte i nevojshëm për të hequr pengesat për regjistrimin e pronës, por pa sukses.

13. Më 2 dhjetor 2008, z. E. K., përfaqësues i autorizuar i Shoqërisë Aksionare “2M” Rozhajë, e regjistruar në Podgoricë, me zyre në Mitrovicë, ushtroi ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: AKK) kundër vendimit të Departamentit, të datës 27 nëntor 2008. (N.B. NSH “Gornji Ibar” dhe ndërmarrja “2M” Rozhajë, u themeluan së bashku me 4 ndërmarrje të tjera si ndërmarrje të reja, pasi që ndërmarrja amë “Trgovina” nga Rozhaja (Mali i Zi) u shpërnda nga ana e Kuvendit të Aksionarëve më 31 korrik 1999).
14. Me vendim të 22 janarit 2009, AKK-ja e refuzoi ankesën me arsyetimin se rasti kishte të bënte me NSH “Gornji Ibar” dhe pronën e paluajtshme që gjendet në Mitrovicë, ndërsa Shoqëria Aksionare “2M” Rozhajë, e kishte autorizuar E. K. që të përfaqësonte ndërmarrjen “2M” Rozhajë, të regjistruar në Mali të Zi. Sipas AKK-së, kjo tregonte se ekzistonin dy subjekte me emra të ndryshëm, i pari ishte NSH “Gornji Ibar”, që po kërkonte regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, ndërsa tjetri ishte subjekti i quajtur Shoqëria Aksionare “2M” Rozhajë, që e kishte autorizuar E. K. nga Mitrovica për ta përfaqësuar atë.
15. AKK-ja më tej theksonte se, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 dhe Ligjit 03/L-067, AKM-ja, respektivisht AKP-ja, ishin të vetmit administrues të besuar për pronën e NSH “Gornji Ibar” dhe rrjedhimisht mund të ishin e vetmja palë në procedurë. Prandaj E. K. si person i autorizuar i personit juridik të quajtur “2M” Rozhajë, nuk i plotësonte kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 38 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, sipas të cilit vetëm palët e interesuara të lejuara me ligj mund të iniciojnë procedurë, gjë që në këtë rast, ishte AKM-ja, respektivisht AKP-ja. AKK-ja konkludoi se ankesa [e E. K.-së] është dashur të refuzohet si ankesë e parashtruar nga pala e paautorizuar.
16. Ankesa administrative e dorëzuar nga ana e NSH-së “Gornji Ibar” në Gjykatën Supreme u refuzua si e pabazuar më 17 korrik 2009, duke qenë se Gjykata ishte e mendimit se pretendimet e paditësit ishin në kundërshtim me gjendjen faktike, siç ishte konstatuar nga ana e AKK-së si dhe me provat në dosjen e rastit, që tregonin se E. K. ishte autorizuar nga ana e “2M” Rozhajë për ta përfaqësuar atë, dhe jo nga paditësi NSH “Gornji Ibar”. Konkludimi i AKK-së se E. K. ishte palë e paautorizuar ishte rrjedhimisht i drejtë dhe se nuk kishte pasur shkelje të ligjit.
17. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, të cilën e parashtrroi Prokurori i Shtetit mbi bazën e asaj se aktgjykimi nuk përmbante arsye sa i përket fakteve vendimtare, u refuzua si e pabazuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 27 gushtit 2010. Gjykata vendosi se mungesa e arsyetimit, sa i përket fakteve vendimtare, nuk paraqiste bazë mbi të cilën Prokurori i Shtetit do të mund të paraqiste kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kësisoj e aprovoi në tërësi konkludimin e shkallës së parë se përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës ishte AKM-ja, respektivisht AKP-ja.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara të Komunës së Mitrovicës, Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe të Gjykatës Supreme shkelet neni 24 [Barazia para ligjit], paragrafi 1, si dhe neni 46 [Mbrojtja e pronës], paragrafi 1, duke ia cenuar të drejtat e tij për mbrojtje të barabartë ligjore dhe të drejtën e pronës.

19. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pa dhënë ndonjë arsyetim se pse Gjykata e njëjtë në procedurën administrative gjeti se përfaqësuesi i tij, E. K., ishte i paautorizuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para ligjit] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e pronës] të Kushtetutës, Gjykata vëren se për të qenë në gjendje për të gjykuar për ankesën e parashtruesit, duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
21. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk mund të ankohej se gjykatat e rregullta kanë bërë lajthim të fakteve apo të ligjit, përderisa dhe për atë sa ato nuk i kanë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj të veprojë si Gjykatë e Apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
23. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat, dhe në përgjithësi procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, janë paraqitur, respektivisht mbajtur në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih *mutatis mutandis*, Aktvendimin për Papranueshmëri të datës 10 mars 2011, në rastin Nr. KI 49/10 Abdullah Shkodra – Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Ac. Nr. 70/2010, të datës 15 prill 2010).
24. Sa i përket rastit të tanishëm, Gjykata vëren se organet administrative dhe Gjykata Supreme kanë shqyrtuar vetëm çështjen paraprake nëse E. K. mund të konsiderohej palë e autorizuar që në emër të parashtruesit të parashtrojë kërkesë për parcelizimin dhe bartjen e paluajtshmërisë së disa ngastrave të caktuara kadastrale, dhe kishin ardhur në përfundim se ai nuk ishte palë e autorizuar. Deri më tani këto institucione me sa duket nuk e kanë shqyrtuar çështjen bazë në lidhje me të drejtën e pronës, për të cilën pretendon parashtruesi i kërkesës.
25. Sa i përket çështjes nëse parashtruesi i kërkesës ka qenë i përfaqësuar në mënyrë të drejtë para instancave të ndryshme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar se në çfarë mënyre aktgjykimet e Gjykatës Supreme kanë qenë të padrejta apo të njollosura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr_ 17064/06, të 30 qershorit 2009 dhe Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005), dhe se kishin paraqitur cenim të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës.
26. Në këto rrethana, kërkesa duhet të hidhet poshtë si qartazi e pabazuar në bazë të rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës i cili parashikon që: “Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

27. Sa i përket kërkesës së parashtruesit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, më konkretisht, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës që përcaktojnë se në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Megjithatë, duke marrë parasysh se kërkesa u gjet si e papranueshme, parashtruesi i kërkesës në bazë të rregullit 54 (1) të Rregullores së punës nuk ka të drejtë të kërkojë masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me rregullin 36 (1c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më ...2011,

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Dr. Iliriana Islami



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani